

Në bazë të nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" numër 5/02) dhe neni 10, pika 5 e Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e RM-së" numër 55/04 dhe 158/11), Këshilli i Qytetit të Shkupit, në seancën e gjashtëdhjetepeshtë të mbajtur më 4 qershor të vitit 2012, solli

Strategji me plan aksional për zhvillim të kulturës të Qytetit të Shkupit për periudhën 2012 - 2015

HYRJE

Krijimi i identitetit të Shkupit si kryeqytet i Republikës së Maqedonisë, kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe vlerësimi në përputhje me politikat aktuale të multikulturalizmit dhe dialogut ndërmjet kulturave, përkrahja e zhvillimit të shumëllojshmërisë kulturore, hapja e institucioneve dhe subjekteve të tjera në fushën e kulturës për publik të ri dhe përmbajtje të reja dhe lidhja ndërmjet komunave në nivel të Qytetit të Shkupit janë vetëm disa nga drejtimet që i ofron kjo Strategji.

Nevojë e domosdoshme e Shkupit është që të ketë Strategji për zhvillimin kulturor, me drejtime të mundshme për përsosmërinë e tij të mëtejshme, me qëllim që të arrihen vlerat e sistemeve bashkëkohore ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen dhe prezantimin e trashëgimisë historike dhe artistike dhe stimulimit dhe prezantimit të krijimtarisë bashkëkohore.

Kjo Strategji duhet t'i mobilizojë në mënyrë plotësuese, para së gjithash, profesionistët nga fusha e kulturës, të punësuarit në institucionet publike kulturore të Qytetit të Shkupit, dhe pastaj të gjithë qytetarët, për aksion të vendosur për rishikimin e vlerave, për vendosjen e qëllimeve të reja dhe mënyrave për pasurimin e jetës kulturore në metropolin tonë.

Nuk mund të ketë prosperitet, bashkëpunim të mirë dhe realizim të partneriteteve, jo vetëm ndërmjet institucioneve ekzistuese të kulturës, por edhe ndërmjet vetë artistëve dhe qytetarëve, pa përcaktimin e drejtimeve të zhvillimit kulturor.

Kjo strategji, vendos disa postulate të rëndësishme kulturore dhe depolitizon ambientin kulturor të qytetit, si faktor i domosdoshëm në rrugën e profesionalizmit dhe evropianizimit.

Gjithsesi që kultura, si segment i pandarë i çdo bashkësie lokale ka potenciale të thella të cilat vlejné që të stimulohen dhe të çlirohen. Duhet të insistohet në zhvillimin e vazhdueshëm të kulturës, i cili është i lidhur ngushtë me transformimin e shoqërisë në tërësi.

Strategjia duhet të shpejtojë procesin e kalimit nga gjendja e tanishme tranzitore në një shoqëri të hapur me dialog të vendosur ndërkulturor dhe komunikim, ku do të jenë më shumë ata që janë të edukuar më shumë nga ana kulturore dhe arsimore, dhe me vetë atë të motivuar, që në mënyrë energjike dhe me besim në vetvete të kontribuojnë në ndryshimin e realitetit të përditshëm në vend human për jetesë.

Vetëm me realizimin e misionit dhe qëllimit të vendosur, strategjia kulturore do të marrë kuptimin e plotë dhe do të jetë e realizuar.

Ky dokument assesi nuk është përgjigje përfundimtare e të gjitha çështjeve, por para se të gjithash, hallka kryesore në vargun e strategjive që do të pasojnë në të ardhmen.

Dokumenti do të ketë edhe transformime të pandërprera dhe do të harmonizohet me të gjitha strategjitë në nivel shtetëror dhe dokumente të tjera me rëndësi të veçantë për kulturën.

QËLLIME STRATEGJIKE

QËLLIMI STRATEGJIK 1: Zhvillimi i modelit pluralist demokratik të politikës

kulturore të Qytetit të Shkupit

Gjendje të identifikuara dhe përshkrim i qëllimit strategjik:

Modeli i themeluar demokratik i definicionit të kulturës dhe realizimi i politikave kulturore mundëson qasje komplekse, pluraliste dhe mikro kundrejt kuptimit dhe promovimit të shumë praktikave kulturore dhe bashkësi të cilat shpërndahen mbi bazën e linjave dhe kategorive të ndryshme (mosha, identifikime subkulturore, gjinia, seksualiteti, pozicioni i marginalizuar social, klasa, etnikumi etj.), dhe të cilat gjenerojnë modele të jetës, praktika të bashkësive dhe produksione, paralele me modelet makro-etnike. Dominimi i hapësirës kulturore nga ana e etnikumit model kufizon frekuencën dhe produksionin e konkurrencës bashkëkohore kulturore-artistike, produksionin dhe kontinuitetin në suazat e veprimtarisë bashkëkohore në kulturën e Qytetit të Shkupit.

Modeli mbi baza demokratike i drejtimit të politikës kulturore do t'i ndjek nevojat e etnikumeve, bashkësive të marginalizuara dhe bashkësive të tjera në qytet, nëpërmjet zbatimit të decentralizimit të plotë dhe përfshirjes së kulturës pluraliste dhe shumëllojshmërisë kulturore, të definuar nëpërmjet zhvillimit të saj të përcaktimeve gjeografike dhe territoriale – qyteti i Shkupit, në vend të pozicioneve të privileguara të identitetit, si etnikum. Një politikë e tillë kulturore pluraliste mundëson kulturë demokratike ose demokratizim të kulturës, implementimin e koncepteve demokratike në kuptimin e kulturës dhe mundëson një qasje të njëjtë te/të gjitha kulturat lokale dhe alternative si burim i kreativitetit dhe invencionit. Modeli mbi baza demokratike, përveç promovimit të konceptit civil, shumëllojshmërisë kulturore dhe njohjes së shumë bashkësive kulturore, duhet të potencojë edhe komunikimin e vazhdueshëm dhe fleksibil, përkatësisht bashkëpunimin ndërmjet pozicioneve kulturore të ndryshme në territorin e qytetit të Shkupit, gjë me të cilën do të promovohen principet e dialogut, plotësimit kulturor dhe transformimit. Nga ana tjetër, duke filluar nga nevojat dhe kushtet e jetës bashkëkohore post-moderne dhe jashtë kufijve, qarkullimi global mediatik i informacioneve, vlerat, pozicionet e identitetit, dijet, praktikat kulturore dhe artistike, modeli demokratik nuk pretendon ta fiksojë pozicionin imagjinar tradicional për sovranitetin ekskluziv dhe të mbyllur territorial. Pikërisht, politika mbi baza demokratike do të përpiqet për zhvillimin dhe promovimin e imagjinatës multidimensionale dhe praktikave të këmbimeve kulturore dhe demokracisë e cila do të distribuojë qasje dhe identifikime nëpërmjet shumë palëve. Në këtë kontekst, kriteret themelore mbi bazën e të cilave do të gjenerohen aktivitetet në fushën e kulturës të Qytetit të Shkupit, si dhe ajo financiare dhe tip tjetër përkrahjeje dhe distribucioni të resurseve financiare, përfshijnë:

- Demokraci
- Hapje
- Mos diskriminim
- Qasje
- Përfshirje
- Decentralizim
- Transparencë
- Bashkëpunim
- Bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërrurban
- Shoqëri civile
- Përzierje të kulturave

Aktivitete:

- Modernizimi i mënyrës së financimit të aktiviteteve nga fusha e kulturës nga Buxheti i Qytetit të Shkupit;
- Zhvillimi i mekanizmave për realizimin e (ri) shpërndarjes së barabartë të buxhetit të destinuar për realizime në suazat e produksionit tradicional, modern dhe kulturor. Krijimi i procedurës për përkrahje të barabartë dhe trajtimi i kulturës moderne, bashkëkohore dhe tradicionale në Shkup;
- Përkrahje publike e barabartë e produksionit kulturor modern, bashkëkohor dhe tradicional;
- Përkrahje e institucioneve të kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit;
- Promocioni i trashëgimisë kulturore nëpërmjet projekteve të turizmit kulturor për promocionin e trashëgimisë kulturore;
- Përkrahje e skenës kulturore profesionale të pavarur; përkrahje e kulturës amatore;
- Përkrahja e kulturës rinore; bashkëpunim me institucionet kulturore; bashkëpunim me organizatat kulturore;
- Bashkëpunim me bashkëpunëtorët kulturor individual;
- Përkujdesje për infrastrukturën publike në suazat e kulturës dhe stimulimi i medimeve të reja dhe kulturës hulumtuese;
- Përkrahje e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Vendosja e sistemit operativ kulturor kualitativ të financimit, me kriteret të precizuara në mënyrë të saktë për shpërndarjen e buxhetit për kulturën të Qytetit të Shkupit, si dhe për të drejtat dhe obligimet e të gjitha organizatave dhe individëve nga fusha e kulturës, të cilat kanë përkrahjen e Qytetit të Shkupit;
- Përcaktimi i kriterëve për kulturën amatore (grupe fokus: amatorë/persona pa arsim formal artistik dhe pa pagim honorarësh dhe pagash për veprimtarinë e tyre projektuese; përkrahje e organizatave kulturore të cilat termin /qëndrimin amatorë e kanë vërtetuar në qëllimet dhe statutin e shoqërisë/organizatës; persona dhe grupe që merren me art si hobi). Në suazat e kulturës amatore do të përkrahen projektet kreative dhe edukative nga kategoritë e arteve interpretuese, arteve muzikore, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit, artit të medimeve të reja dhe literaturës /librit/album strip/novela grafike;
- Përcaktimi i kriterëve për kulturën rinore (grupe fokus: fëmijë dhe të rinj, projekte, të iniciuara nga fëmijët dhe të rinjtë, nën tutorinë e personave të rritur, projekte artistike dhe kreative për fëmijë dhe të rinj; kopshte, shkolla fillore, shkolla të mesme), nxitja dhe zhvillimi i kulturave të ndryshme rinore dhe subkulturave. Në suazat e kulturës rinore do të përkrahen projektet kreative dhe edukative nga kategoritë e arteve interpretuese, arteve muzikore, arteve vizuale, arteve të medimeve të reja dhe literaturës /librit/album strip/novela grafike;
- Përcaktimi i kriterëve për zgjedhje, numër, mandat dhe obligime dhe komisione profesionale;
- Formimi i komisioneve eksperte;
- Përgatitja e Rregullores.

Korniza kohore: 2012-2015

QËLLIMI STRATEGJIK 2: Transparencë, profesionalizëm dhe efikasitet në veprimtarinë e kulturës në Qytetin e Shkupit

Identifikimi i gjendjeve dhe përshkrimi i qëllimit strategjik:

Realizimi i plotë i aktiviteteve në fushën e kulturës, si dhe aktivitetet, masat, aksionet dhe angazhimi i/dhe në Qytetin e Shkupit, akoma ka nevojë për përmirësimin në lidhje me transparencën gjatë sjelljes së vendimeve dhe politikave. Distribucioni i resurseve financiare dhe bashkëpunimi i Qytetit të Shkupit me aktorët e tjerë të kulturës dhe punëtorët në qytet, si dhe transparenca e institucioneve kulturore nën

kompetencat e Qytetit të Shkupit, janë në kontekstin e realizimit të programeve kulturore dhe bashkëpunimit me aktorët kulturor.

Gjithsesi zhvillimi i politikave kulturore në nivel të qytetit të Shkupit është i lidhur edhe me nevojën për perfeksionim në lidhje me profesionalizmin dhe trajnimin e kuadrove që janë përfshirë në realizimin e programeve kulturore në nivel të Qytetit të Shkupit dhe institucionet kulturore nën kompetencat e qytetit. Kjo nevojë ka të bëjë edhe me kualifikimin plotësues të kuadrove në institucionet kulturore, në lidhje me ndjekjen e trendëve bashkëkohore dhe politikave në muzeologji, me shumë mekanizma të bashkëpunimit, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin në fushën e kulturës, si dhe ndryshimet dhe aktualitetet në praktikat bashkëkohore dhe trendët në suaza botërore.

Në bazë të këtyre problemeve të përcaktuara, qyteti i Shkupit si qëllim strategjik vendosi zhvillimin dhe implementimin e mekanizmave të përcaktuara qartë për transparencë në proceset e zbatimit të politikave dhe programeve kulturore, gjë me të cilën do të vendosen kritere të larta demokratike mbi bazën e të cilave qytetarët dhe aktorët kulturor do të përfshihen plotësisht dhe do jenë të informuar për proceset e sjelljes së vendimeve, si dhe për përgatitjen dhe realizimin e programeve kulturore dhe strategjisë për kulturën e Qytetit të Shkupit. Transparenca në veprimtarinë në fushën e kulturës do të përbëjë imperativ për të gjitha instancat e përfshira në rrjetin institucional në fushën e kulturës së Qytetit të Shkupit dhe në atë mënyrë do të përbëjë kusht themelor për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave participues dhe metodave në procesin e sjelljes së vendimeve në lidhje me çështjet e kulturës, si dhe për hapjen e Qytetit të Shkupit dhe institucioneve kulturore nën kompetencat e Qytetit të Shkupit për bashkëpunimin me sektorin civil, të përfshirë në mënyrë aktive në produksionin kulturor në shkallë qyteti. Vendosja e transparencës si imperativ dhe qëllim do të kontribuojë edhe drejt hapjes së institucioneve kulturore dhe Qytetit të Shkupit për dhe në përputhje me nevojat e sektorit civil në fushën e kulturës, si dhe të punëtorëve të kulturës dhe nevojave të tyre krijuese dhe të punës dhe problemeve. Në këtë mënyrë, Qyteti dhe institucionet kulturore të Qytetit të Shkupit do t'i bëjnë të arritshme për publikun të gjitha programet dhe aktivitetet e veta, duke ofruar në dispozicion kapacitetet dhe resurset e veta, me qëllim – zhvillimin e modelit demokratik të suksesshëm të bashkëpunimit. Ngritja e shkallës së profesionalizmit e të gjithë individëve dhe institucioneve të përfshira në procesin e realizimit të programeve kulturore dhe strategjive të qytetit të Shkupit, nëpërmjet kriterëve për seleksionim të përcaktuara qartë, angazhimit dhe punësimit, si dhe trajnimit në kontinuitet në suazat e trendëve bashkëkohore, lëvizjeve dhe aktualiteteve në fushën e kulturës dhe punën kulturore në shkallë ndërkombëtare, përbën qëllim strategjik me rëndësi të veçantë për qytetin e Shkupit.

Aktivitete:

- Ridefinimi i mënyrës për veprim transparent në kulturën e Qytetit të Shkupit, në institucionet kulturore, organizatat kulturore dhe punëtorët e kulturës; nëpërmjet shpalljeve publike dhe të arritshme të të gjitha dokumenteve relevante të tipit:

- Shpallja e konkurseve vjetore dhe rezultateve të konkursit
- Shpallja publike e komisioneve dhe kryetarëve të komisioneve
- Shpallja publike e projekteve të miratuara në programin në vijim
- Shpallja publike e mjeteve financiare të ndara për çdo projekt të miratuar dhe program

- Shpallja publike e Strategjisë për kulturën e Qytetit të Shkupit me Planin aksionar, 2012 – 2015
- Zbatimi i ndryshimeve në konkurs për programet dhe projektet vjetore, ku duhet të përfaqësohen këto etapa:
 - Përcaktimi i rregullave dhe kriterëve për paraqitjen e projektit sipas fushave të caktuara
 - Buxheti i destinuar për kulturë do të planifikohet në përputhje me projektet e paraqitura nga fusha të ndryshme sipas kriterëve të përcaktuara më parë me rregullore
 - Përkrahje e institucioneve të themeluara nga Qyteti i Shkupit
 - Fusha të kulturës:
 - Arte interpretuese
 - Arte muzikore
 - Arte vizuale
 - Arti i medimeve të reja
 - Veprimtari botuese
 - Bibliotekari
 - Kultura rinore
 - Kultura amatore
 - Turizmi kulturor dhe promocioni i trashëgimisë kulturore
 - Veprimtari muzeore
 - Bashkëpunim ndërkombëtar
- Përcaktimi i kohëzgjatjes së procesit të kontrollit, seleksionimit dhe zgjedhjes për përkrahjen e projekteve. Përcaktimi i mënyrës për informimin e argumentuar dhe në kohë të grupeve dhe individëve për arsyet për projektet e refuzuara dhe të miratuara; përcaktimi i përmbajtjes dhe kohës për nënshkrimin e kontratës; përcaktimi i realizimit të projektit, të financuar nga Qyteti i Shkupit;
- Realizimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare që do të përfshijnë projekte partneriteti, vizita dhe shfaqje të ndryshme publike, anëtarësim për rrjete dhe organizata të rëndësishme ndërkombëtare;
- Anëtarësimi i Qytetit të Shkupit në organizatat kulturore dhe artistike botërore, anëtarësime në rrjetëzime ndërkombëtare;
- Formimi i komisioneve me karakter të kombinuar – të përbëra nga bashkëpunëtorë profesional të jashtëm dhe të punësuar të brendshëm nga Qyteti i Shkupit (komisioni profesional duhet të propozojë kryetarin; anëtarët e jashtëm të komisionit profesional do të angazhohen me honorar dhe sipas nevojës; çdo anëtar dhe kryetar komisioni do të veprojnë në një periudhë të caktuar kohore/mandat). Formimi i shumë komisioneve profesionale të destinuara në veçanti për çdo fushë në kulturë:
 - Komisioni profesional për veprimtari amatore dhe rinore në fushën e arteve vizuale dhe nga fusha e artit të medimeve të reja

- Komisioni profesional për veprimtari amatore dhe rinore në fushën e arteve interpretuese
- Komisioni profesional për veprimtari amatore dhe rinore në fushën e arteve muzikore
- Komisioni profesional për veprimtari amatore dhe rinore në fushën e veprimtarisë bibliotekare
- Komisioni profesional për bashkëpunim ndërkombëtar
- Komisioni profesional për veprimtari amatore dhe rinore në fushën e turizmit kulturor për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe veprimtarisë muzeore

-Trajnimi i të punësuarve në Qytetin e Shkupit, për veprimin efikas dhe bashkëpunimin në suazat e kulturës dhe nevojave aktuale të saj, trendëve, rrjedhave dhe përdorimi i teknologjisë së re;

- Përgatitja e platformave digjitale gjithëpërfshirëse-informatike dhe portaleve të kulturës (sipas shembullit të www.culture.si, www.culture.uk, www.culture.de ... Përgatitja e këtij tipi të integruar të platformave digjitale do të zgjidhin deficitin informativ të qytetarëve, punëtorëve të kulturës nga vendi ynë, regjioni, Evropa dhe bota— të cilat iniciojnë bashkëpunime kulturore me/në Maqedoni, sepse ato mundësojnë shikimin e informacioneve për trashëgiminë kulturore lokale, kulturën dhe artin bashkëkohor dhe modern, turizmin kulturor dhe turizmin, gastronominë; jetën shoqërore, kulturore, ekonomike dhe politike në vend, në një hapësirë funksionale digjitale me të dhëna të arritshme informative dhe kontakte);

- Krijimi i mekanizmit për bashkëpunimin në kontinuitet ndërmjet Sektorit për veprimtari publike / seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe mediumeve; për përgjegjësinë e tyre mediatike dhe përfshirjen e tyre në proceset e veprimtarisë së Sektorit për veprimtari publike / seksionit për kulturë / Qyteti i Shkupit;

- Përgatitja e Rregullores së vetme;

- Përgatitja e Strategjisë për zhvillim kulturor të Qytetit të Shkupit për periudhën 2015 – 2020.

Korniza kohore: 2012 – 2013

Qëllimi strategjik 3: Zhvillimi i modelit efikas për bashkëpunim ndërmjet

institucioneve të ndryshme, organizatave, seksioneve, sektorëve dhe aktorëve nga fusha e kulturës e Qytetit të Shkupit

Identifikimi i gjendjeve dhe përshkrimi i qëllimit strategjik:

Niveli i pamjaftueshëm i koordinimit të krijimit të vektorëve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme, institucioneve dhe aktorëve në kulturë, shpesh rezulton me: a) informimin e pamjaftueshëm të përbashkët për aktivitetet në sektorë të ndryshëm në fushën e kulturës; c) përputhja e aktiviteteve me karakter të njëjtë

ose të ngjashëm; ç) efektivitet i pamjaftueshëm dhe largpamësi e aktiviteteve të realizuara dhe rezultateve të; d) dobësim i komunikimit dhe mediatimit të informacioneve të karakterit kulturor dhe artistik deri te publiku i gjerë; dh) rritja e mosbesimit ndërmjet institucioneve të ndryshme, institucioneve dhe aktorëve; e) dobësimi i kapaciteteve të përbashkëta për kryerjen e efektive dhe të fuqishme të ndikimit mbi bartësit e tjerë të vendimeve në jetën politike në nivel lokal dhe nacional; ë) zvogëlimi i mundësive për plotësimin kolaborues dhe lidhjen e kapaciteteve individuale të planit teknik, dhe profesional, si dhe mbyllja relative e institucioneve dhe organizatave në perspektivën e krijimeve të platformave të përbashkëta të tipave dhe qëllimeve të ndryshme.

Mungesa e bashkëpunimit gjithashtu reflektohet edhe në reproduksionin e politikave përjashtuese kulturore-identitetit, pikërisht mungesën e dialogut kulturor ndërmjet traditave të ndryshme kulturore dhe bashkësive në territorin e qytetit të Shkupit, që, nga ana tjetër, dobëson për zhvillimin e shoqërisë civile, multikulturore dhe të hapur. Përfundimisht, shkalla e pamjaftueshme e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm në fushën e kulturës rrit rrezikun nga mos krijimi i rrjeteve ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe financimit si model për ruajtjen dhe promocionin e vlerave kulturore dhe produksionit artistik në territorin e qytetit të Shkupit jashtë kufijve lokal dhe nacional.

Në bazë të problemeve të identifikuara, qyteti i Shkupit, zhvillimin e modelit efikas për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ndryshme, organizatave, sektorëve dhe aktorëve nga fusha e kulturës e thekson si një nga qëllimet e veta strategjike parësore për periudhën 2012-2015, dhe e veçon si një nga kushtet kryesore për zbatimin e politikës demokratike dhe civile, të bazuar në principet e bashkëpunimit, rrjetëzimit, këmbimit dhe hapjes. Në të njëjtën kohë, realizimin e këtij qëllimi strategjik e shikojmë si një hap përpara drejt efektivitetit të shumë aksioneve dhe aktorëve në kulturë, si dhe drejt qëndrueshmërisë dhe partneriteteve afatgjata dhe të qëndrueshme në suazat e rrjetit të mbrojtësve të potencialit kulturor dhe krijimit të territorit të Qytetit të Shkupit. Zhvillimi i mekanizmit efektiv të bashkëpunimit do të përbëjë kusht edhe për ndërtimin e partneriteteve të modeluara afatgjata dhe të suksesshme në shkallë ndërkombëtare, si kusht për ruajtjen dhe promocionin e produksionit lokal kulturor dhe arritjeve.

Aktivitete:

- Përgatitja e strategjive individuale për kulturën 2013-2016 nga ana e institucioneve kulturore nga Qyteti i Shkupit në përputhje me qëllimet e përcaktuara në Strategjinë e Qytetit të Shkupit;
- Përgatitja e obligueshme e ueb-faqes nga ana e të gjitha institucioneve kulturore, qartësia e tyre, mirëmbajtja e vazhdueshme, azhurnimi dhe plotësimi;
- Shqyrtimi i zhvillimit të përbashkët të mënyrave të mundshme të ndryshme për bashkëpunime stimuluese të përbashkëta me organizatat e pavarura kulturore, në suazat e proceseve, obligimeve dhe nevojave të skenës kulturore të pavarur në qytet;
- Përkrahje e iniciativave për shqyrtimin e të gjitha kombinimeve të mundshme inventive për lidhje partneriteti dhe bashkëpunim gjatë realizimit të projekteve eksperimentuese të ndryshme progresive, në kontekste lokale, regjionale dhe

ndërkombëtare, përkrahje e qasjeve të reja tematike dhe mediatike në krijimin artistik;

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet Sektorit për veprimtari publike – Seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe institucioneve kulturore nëpërmjet realizimit të projekteve të rëndësishme dhe afatgjata dhe projekteve të tjera të bashkëpunimit me karakter lokal dhe ndërkombëtar. Në këtë kontekst kryesore janë edhe aktivitetet që çuan në rritjen e qasjes deri te institucionet kulturore për bashkëpunimin me skenën e pavarur, si dhe hapjen e institucioneve kulturore për bashkëpunim *not for profit / jo për fitim*, me dallime të qarta ndërmjet pjesës komerciale dhe jokomerciale në program dhe projekt. Përfundimisht, në këtë grup aktivitetesh hyn edhe përfshirja e kontratave ndërmjet institucioneve kulturore dhe bashkëpunëtorëve të tyre të jashtëm (individë dhe organizata);

- Ridefinimi i bashkëpunimit ndërmjet Sektorit për veprimtari publike – Seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe komunave lokale (seksionet e komunave për kulturë dhe arsim);

- Ridefinimi i bashkëpunimit dhe obligimet ndërmjet (Sektorit për veprimtari publike – Seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe Ministrisë së kulturës);

- Ridefinimi strategjik i bashkëpunimit ndërmjet Sektorit për veprimtari publike – Seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe medimeve;

- Përkrahje e bashkëpunimit ndërkombëtar në kulturë. Hap veçanërisht i rëndësishëm në kontekst të këtyre aktiviteteve përbëjnë: stimulimi dhe përkrahja e bashkëpunimeve të ndryshme ndërkombëtare, përkrahje e projekteve kulturore dhe edukative të ko-financuara nga fondet e BE-së dhe nga fondacione të tjera evropiane, stimulimi i projekteve të partneritetit, zbatimi i iniciativave për rrjetëzime të ndryshme dhe anëtarësime ndërkombëtare të Qytetit të Shkupit;

- Nxitja e zhvillimit të mekanizmave efikas dhe modeleve për zbatimin e partneriteteve publike/private në kulturë, partneriteteve publike/civile, civile-private. Në realizimin e këtij aktiviteti theks i veçantë do të vendoset mbi kategorizimin dhe sqarimin e dallimeve ndërmjet partneriteteve fatprurëse dhe jofitimprurëse, si dhe stimulimin e të ashtuquajturave partneritete të mundshme *``jo për fitim``* në partneritet me institucionet e qytetit dhe nacionale. (Ilustrim i modeleve të partneritetit: partneritete publike/civile; OJQ dhe SHPK; institucione kulturore dhe SHPK; institucione nacionale, institucione kulturore, komuna, Qyteti i Shkupit, Ministria e kulturës dhe organizata të pavarura kulturore/shumë organizata të pavarura kulturore; SHPK, institucione nacionale, institucione kulturore, komuna, Qyteti i Shkupit, Ministria e kulturës dhe organizata e pavarur kulturore/shumë organizata të pavarura kulturore);

- Zhvillimi i mekanizmave dhe modeleve mundësojnë promocionin e trashëgimisë kulturore të Qytetit të Shkupit nëpërmjet turizmit kulturor (krijimi dhe realizimi i programeve për përkrahjen dhe zhvillimin e kulturës/ofertës turistike, theksimi i rëndësisë së turizmit lokal kulturor dhe aspekteve të tij moderne, bashkëkohore dhe tradicionale).

Korniza kohore: 2012 – 2015

QËLLIMI STRATEGJIK 4: Iniciativa për ridefinimin e kornizës nacionale kohore në fushën e kulturës në përputhje me nevojat bashkëkohore të kulturës dhe punëtorëve të kulturës

Gjendje të identifikuar dhe përshkrimi i qëllimit strategjik:

Eksperienat e një numri të madh të organizatave nga fusha e kulturës, si dhe e përfaqësuesve të institucioneve kulturore të Qytetit të Shkupit tregojnë për nevojën e ndryshimeve dhe përmirësimeve në nivel të legjislacionit nacional në kontekst të kulturës. Pengesat me të cilat ballafaqohen aktorët e kulturës në procesin e punës, menaxhimi, hulumtimi dhe prodhimi si faktor i drejtpërdrejtë përbëjnë nyjat e

ndryshme dhe mungesat në legjislacionin ekzistues. Që këtu ekziston domosdoshmëria për një shqyrtim sistematik dhe të hollësishëm të legjislacionit, analizimin krahasues të tij dhe krahasimin me legjislacione të tjera regjionale apo evropiane nacionale, si dhe me rekomandimet e përcaktuara qartë dhe kërkesat, që reflektohet edhe në rolin e deritanishëm dhe bashkëpunimin ndërmjet sektorit civil dhe Qytetit të Shkupit në procesin e sjelljes së vendimeve në nivel më të lartë. Në këtë drejtim theksohet edhe nevoja për zhvillimin e kapaciteteve të Qytetit të Shkupit dhe sektorit civil për lobimin dhe përfaqësimin e përbashkët dhe qasje aktive në relacionin me bartësit e vendimeve. Shqyrtimi sistematik i kornizës ligjore nacionale, si dhe dispozitat ligjore në fushën e kulturës në nivel lokal, nëpërmjet të cilave do të zhvilloheshin konkluzione konkrete, propozime dhe rekomandime, do të përbënin një mjet konkret për përfaqësim dhe kërkesa për ndryshime ligjore. Përkrahja dhe bashkëpunimi i Këshillit të Qytetit të Shkupit në këto procese përbën një nga faktorët kryesor, pikërisht pozicioni i Qytetit të Shkupit si i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në proceset e përfaqësimit dhe sjelljes së iniciativave për ndryshime ligjore dhe sjelljen e politikave në nivel nacional dhe para Ministrisë së kulturës së RM-së.

Aktivitete:

- Krijimi i qasjes dhe modelit për bashkëpunim me Ministrinë e kulturës në fushën e suazave ligjore në kulturë;
- Analiza, plotësime, rekomandime dhe përfaqësime për realizimin e plotësimeve/ ndryshimeve në Ligjin për kulturën;
- Analiza, plotësime, rekomandime dhe përfaqësime për realizimin e plotësimeve / ndryshime në Ligjin për donacione dhe sponsoritete në veprimtaritë publike;
- Analiza, plotësime, rekomandime dhe përfaqësime për realizimin e plotësimeve / ndryshime në Ligjin për shpalljen e Çarshisë së vjetër të Shkupit si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë;
- Analiza, plotësime, rekomandime dhe përfaqësime për realizimin e plotësimeve / ndryshime në Ligjin për bibliotekat.

Korniza kohore: 2012 – 2015

QËLLIMI STRATEGJIK 5: Zhvillim i mekanizmave dhe modeleve efikase për shfrytëzimin e mjediseve publike / mjediseve të hapura në kulturë

Gjendje të identifikuarra dhe përshkrim i qëllimit strategjik:

Dhe përkundër disa manifestimeve të karakterit të hapur të organizuara nga Qyteti i Shkupit dhe të cilat kanë për qëllim animimin e qytetit dhe mjedisin publik përmes përdorimit të mjeteve kulturore, përdorimit, aproprijimit dhe kreativitetit, rifunksionalizimi i mjedisit publik në Shkup paraqet ende terren të pa hulumtuar sa duhet dhe mundësi për prodhim kulturor dhe artistik. Praktikart artistike në qytet ende janë të lidhura ngushtë me prezantimet e orientimit ekspozues dhe muzeor të prodhimeve artistike, ndërsa aktualizimi artistik dhe kulturor dhe përdorimi i mjedisit publik mbeten si mjedise të pa hulumtuara për intervenime kreative të cilat do ta afirmonin principin dhe idealin normativ për mjedis publik, kurse sipas tyre mjediset

publike paraqesin arena afrimi, të përbashkëta të hapura për dialog, krijim dhe jetesë.

Në këtë mënyrë roli i punëtorëve dhe aktorëve kulturor në qytet ende mbetet relativisht e pavërejtur kur bëhet fjalë për kontributin kreativ në zhvillimin urban dhe gjallërimin dhe promovimin e potencialit demokratik, përkatësisht shprehjes artistik të transformimeve aktuale kulturore dhe atyre të vazhdueshme ose bashkëkohore dhe ndërtim të identitetit urban të Qytetit. Këto mangësi identifikohen jo vetëm në kontekst të mjediseve të hapura publike si lokalitete të mundshme për prodhim dhe prezantim artistik dhe kulturor, por edhe në kontekst të mjediseve dhe objekteve të ndryshme të hapura funksionale dhe të destinuara të cilat ofrojnë mundësi për vënie në funksion të interaksionit kreativ dhe inventiv mes artistëve dhe qytetarëve përkatësisht nevojave sociale.

Problemet të cilat mund të identifikohen si pengesë për zhvillimin e interaksionit mes praktikave artistike, produksionit kulturor dhe mjedisit publik dhe zhvillimit urban, përfshijnë më shumë elemente, si: a) shprehitë dominuese kulturore dhe artistike, të zhvilluara nëpër format dhe kanonet e institucionalizuara të shprehjes artistike në Maqedoni; b) barrierat burokratike dhe akademike të cilat paraqiten para aktorëve të interesuar; c) pengesat dhe vështirësitë ligjore të cilat shpesh e demotivojnë procesin dhe iniciativat për intervenim në mjedisin publik; ç) privatizimi masiv i pjesës së madhe të mjediseve dhe objekteve publike si dhe d) koordinimi jo i mjaftueshëm dhe iniciativë e përbashkët në nivel lokal dhe kombëtar, përkatësisht pushtetit lokal dhe shtetëror etj.

Si problem i veçantë i cili u theksuar në procesin e debatit publik gjatë përgatitjes së Strategjisë, u shënuar mungesa e pasqyrës së evidentuar të mjediseve dhe objekteve të hapura ekzistuese dhe të disponueshme nën kompetencë të Qytetit dhe shtetit, në territorin e qytetit të Shkupit, si dhe mekanizma rregullimi dhe rregulla të përcaktuara qartë për shfrytëzimin e mjediseve publike dhe të hapura, duke përfshirë përfitime specifike të cilat do të ofroheshin për iniciativa të cilat kanë për qëllim intervenimin kulturor – artistik në qytet.

Nga këto shkaqe, qyteti i Shkupit do të bëjë përpjekje të mëdha për hapjen e mjediseve publike për produksion të angazhuar kreativ, artistik, kulturor dhe social, me qëllim që mjediset publike të kenë dhe të gjallërojnë potencialin thelbësor për adaptimin dhe transformimin në përputhje me nevojat aktuale kulturore dhe sociale të qytetarëve. Ky qëllim në vete përfshin dhe zgjerimin e imagjinatës sociale dhe mobilizimin e strukturave të përcaktuara të jetesës urbane, por edhe promovimin e identitetit urban modern dhe ndryshim të tendencave anakrone të cilat nuk përputhen me format moderne të jetesës së qytetarëve.

Më tutje, përpjekje të veçantë të Qytetit do të paraqesë nxitja dhe rritja e dukshmërisë të produksionit artistik, socializim i saj dhe afrim deri te përditshmëria e qytetarëve, si dhe nxitja e shkëmbimit kulturor mes bashkësive të ndryshme dhe përcaktimeve identifikuese në qytet, përkatësisht afirmim i jetesës multikulturore me të gjitha manifestimet e saj pluraliste dhe të llojllojshme. Produksioni kulturor përmes përdorimit të mjedisit publik dhe të gjitha mjediseve të hapura në qytet në këtë mënyrë do të bëhet një nga forcat lëvizëse themelore në organizimin e qytetit si mjedis dinamik, i ndryshueshëm dhe pluralist për shkëmbimin, komunikimin dhe interaksionin mes qytetarëve, përkatësisht aktor për krijimin e imagjinatave dhe përfaqësimeve alternative, por edhe i organizatave të jetesës dhe zhvillimit urban.

Aktivitete:

- Hapje dhe adaptim i mjediseve publike për qëllimet për nxitjen e kreativitetit dhe dinamikës kulturore;
- Zhvillim dhe realizim i projektit *Evidentim i qytetit të Shkupit* (Evidentim dhe kontroll i lokaliteteve të qytetit: të braktisura/të lëna pas dore, hapësirave të padefinuara nga ana juridike dhe objekteve nëpër Shkup dhe rrethinën e saj / komnatat përreth);
- Përgatitje e konceptit/projektit/planit për realizimin e projektit trienal/kuadrienal, me titull pune *Veshje e Shkupit*;
- Plotësim i rregullores ekzistuese për shfrytëzimin e mjedisit publik të Sektorit për punë komunale.

Korniza kohore: 2013 – 2015

QËLLIMI STRATEGJIK 6: Nxitje e zhvillimit të industrive kreative

Gjendje të identifikuar dhe përshkrim i qëllimit strategjik:

Përkrahja e zhvillimit ekonomik të Maqedonisë gjatë periudhës së tranzicionit përmes lidhjes në fushave ekonomike dhe kulturore të jetesës mbetet ende në mundësi të ulëta të shfrytëzimit. Përderisa në sistemin e kaluar, si sistem i centralizuar ekonomik, në art dhe kulturë shikoheshë si në fusha të izoluar nga çdo lloj vlere komerciale që çdo herë duhej të përkrahej financiarisht nga shteti, sot kultura kuptohet sa vjen e më shumë si mundësi për biznes..

Industritë kreative janë aktivitete të cilat burimin e tyre e gjejnë në kreativitetin, mjeshtërinë dhe talentin individual, dhe të cilat kanë potencial për krijimin e pasurisë dhe punësimin përmes gjenerimit dhe shfrytëzimit të pronësisë intelektuale. Edhe pse ende është pak e zhvilluar edhe në Maqedoni sa vjen e më shumë vërehet potenciali i sektorit kreativ që kontribuon në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë transitore. Përvojat tregojnë se shumë agjenci ndërkombëtare mendojnë se si ta përkrahin këtë zhvillim dhe si ta lehtësojnë këtë zhvillim, por edhe si të mundësojnë që sukcesi në këtë sektor në botën e zhvilluar të reflektohet në skemat e zhvillimit të planifikuar dhe krijimin e punësimeve edhe në vende në zhvillim, përkatësisht në ato vende ku kjo lidhje ende nuk është e përgatitur sa duhet dhe të orientohet nga ana strategjike në prodhimin e zhvillimit të ekonomisë dhe vetëpunësimin.

Zhvillimi i strategjisë lokale për zhvillim të industrive kreative kërkon qasje të dukshme sensitive në definimin dhe seleksionimin e sektorëve adekuat kulturor dhe kreativ kombinimi dhe funksionalizimi i të cilit në drejtim të përfitimit ekonomik dhe zhvillimit duhet të jetë i adaptuar nga ana konceptuale, që nënkupton ndjekje e vëmendshme e kushteve dhe mundësive që konteksti lokal dhe historia kulturore dhe politike i gjeneron.

Indikator pozitiv në këtë drejtim është ekzistimi i klimës së volitshme dhe ekzistimi i interesit nga institucionet relevante të cilat janë të interesuara të kyçen në proces të tillë, duke përfshirë Entin shtetëror për pronësi intelektuale, i cili përmes hulumtimeve dhe analizave të tij do të paraqisnin burim të veçantë informimi me çka realisht do të vështrohen gjendja e industrive kreative në terren në Shkup, por edhe në Maqedoni. Në këtë drejtim, ndërliken edhe faktet që Shkupi prej para dy vitesh është anëtar zyrtar i rrjetit të qyteteve kreative Les Rencontres të cilat punojnë në zhvillimin e sektorit Industri kreative. Në vitin 2009 edhe tek ne janë zhvilluar hulumtime të caktuara, përkatësisht Ministria për kulturë e RM dhe Këshilli britanik në Maqedoni e

publikoju Hartimin e industrive kreative në Republikën e Maqedonisë, e cila mund të shërbejë si bazë për zhvillimin e projektit në nivel lokale të qytetit të Shkupit

Është e rëndësishme të shënohet se industritë kreative, nga ana tjetër ofrojnë mundësi për adaptim të tyre të lehtë në ndërlikimet të cilat i sjell ndeshja mes lokale dhe globale. Në fakt, edhe krahas formave globale të cilat më pak ose më shumë janë homogjenizuese në perspektivën e diversitetit kulturor, rezultati nga industritë kreative tregon tendencë për rritjen e diversitetit si rezultat i mbështetjes në produksionin kreativ mbi specifikat dhe resurset lokale. Në këtë mënyrë, krahas aspekteve formale të marketingut dhe distribuimit të cilat menaxhohen në korniza dhe standarde globale potenciali individual, puna kreative dhe rrethanat dhe materialet specifike kulturore, krijojnë kushte për promovimin e traditave autentike kulturore, si dhe aspekteve specifike bashkëkohore të një shoqërie

Në këtë drejtim, qyteti i Shkupit mund të vështrohet si vend për takim mes nurit të dukshëm të ndikimeve të brushme, por edhe të jashtme, të akultururara në mënyrë specifike, ndikime kulturore, sociale dhe teknologjike, të gjitha do të paraqesin bazë për krijimtari, inovacion, por edhe lëndë promovimi. Nga ana tjetër, rrjeti i gjerë i kapitalit të zhvilluar kreativ dhe potenciali në Shkup, zhvillimi i dukshëm i veprimtarive të caktuara artistike dhe kreative, por edhe zhvillimi i ndërgjegjes për avancimin e potencialit ekonomik në degë të caktuara tradicionale dhe kreative, si dhe përvojat e suksesshme të një pjesë të sektorëve të cilat janë nën ombrellën e termit – industri kreative, tregojnë se ekziston material parimor mbi bazë të të cilit mund të zhvillohet kjo veprimtari. Megjithatë, është rëndësishme të theksohet se gjatë kësaj duhet të kemi kujdes një segment shumë i rëndësishëm dhe kyç dhe ky është zgjidhja dhe vendimi se cilat prodhime dhe cilat shërbime do të krijohen, shiten dhe përfshihen në këtë sektor.

Në bazë të asaj që është elaboruar më lartë, Qyteti i Shkupit si një nga qëllimet e saj thelbësore strategjike e ka zhvillimin në projekt konkret të nevojës për investim në këto degë ekonomike të cilat sjellin dobinë më të madhe ekonomike (t.a.q. vlera plotësuese) dhe me këtë të realizohet dhe hapja e vendeve të reja të punës dhe të konkretizohet me rezultat pozitiv përkujdesi për kuadrot e reja të shkolluara kreative. Në këtë drejtim, si qëllim strategjik Qyteti e vendos realizimin e më shumë aktiviteteve të cilat duhet të definojnë konceptin e hapjes së Qendrës të Industrive kreative i cili në vete do të bashkojë fusha siç janë: arkitektura, dizajni, arti vizual, video lojërat, Tv produksioni, IT teknologjitë, përgatitja e pajisjeve programuese për kompjuterë (softuer), marketing, ekologji, trashëgimi kulturore etj. në këtë drejtim qëllimi është zhvillimi i Shkupit si SHKUP KREATIV, por gjithsesi jo përmes përgatitjes së materialeve promocionale dhe subvencioneve, por në formë të ndihmës indirekte, krijim i mjediseve dhe organizim rreth të cilit do të mblidhen dhe do të zbulohen qytetarët më të talentuar dhe më të aftë nga Shkupi dhe Maqedonia (duke përfshirë edhe ata që janë larguar ose kanë mërguar nga vendi), gjatë së cilës duke krijuar prodhime dhe shërbime mjaft interesante dhe tërheqëse të cilat mund të sjellin benefit të caktuar ekonomik.

Aktivitete:

- Zhvillimi i Qendrës për industri kreative të zbatohet në kornizat e planit katërvjeçar;
- Aktivitetet e Qendrës për industri kreative, do të zbatohen në kornizat e festivalit SHKUPI KREATIV;
- Hulumtim;
- Përgatitje e planit të punës dhe atij financiar;

- Sigurim i hapësirave;
- Menaxhim me hapësirën dhe programet;
- Stimulim i projekteve multimediale.

Korniza kohore: 2011 – 2015

QËLLIMI STRATEGJIK 7: Nxitje dhe zhvillim i modelit të ri të organizimit të hapur kulturor si servis publike për të gjitha shoqatat dhe artistët individual nga fusha e kulturës

Gjendje të identifikuar dhe përshkrim i qëllimit strategjik:

Si një nga problemet kryesore me të cilat përballet skena e pavarur kulturore në qytetin e Shkupit, në krijimin dhe realizimin e vizioneve, misioneve dhe përcaktimeve të saj programore, i theksuar nga përfaqësues të sektorit qytetar, është mungesa e hapësirave, resurseve dhe kushteve për realizimin e aktiviteteve të karakterit kulturor dhe bashkëkohor – artistik. I vënë në kontekst të burimeve dhe qëndrueshmërisë financiare të organizatave të nivelit lokal, theksimi i këtij problemi reflektohet edhe më shumë në kushtet për punë të skenës së pavarur kulturore e cila i përfshin domenet e pagimit të punës, mjete për teknikë dhe realizim konkret të ngjarjeve dhe produksionit, sigurim i infrastrukturës bazë, fleksibilitetit ekstrem të orarit të punës e cila më tutje i redukton kapacitetet e tyre për përkushtim në zhvillimin e partneriteteve dhe aktivitete të karakterit internacional, si dhe angazhim më aktiv me shoqërinë civile dhe të rinjtë etj.

Udhëzimet e përfaqësuesve të skenës së pavarur kulturore, më tutje paraqesin vështirësitë dhe implikimet në pavarësinë e produksionit të tyre të cilat dalin nga restriksioni i burimeve internacionale të financimit. Nga ana tjetër, nëse shqetëson indikacioni për ardhmërinë e zhvillimit të produksionit të pavarur kulturor shpesh herë paraqitin dhe shkurtime të resurseve financiare internacionale të destinuar për përkrahjen e kulturës dhe determinizmin e distribuimit të granteve dhe përkrahje për domene jashtë nga kultura dhe arti, ose për aktivitete të orientuara vetëm drejt vetë qëndrueshmërisë profitabile.

Proceset e debatit publik në lidhje me përgatitjen e udhëzimeve themelore strategjike në zhvillimin e politikave kulturore të qytetit të Shkupit, nga ana tjetër, paraqitën pozitat e theksuara konfliktuoze mes sektorit të pavarur kulturor dhe institucioneve publike nga fusha e kulturës, përkatësisht të hendeqeve të dendura në mundësinë për dialog, bashkëpunim, zhvillim të partneritetit, formave të menaxhimit, papajtueshmërive programore, konflikteve në shpërndarjen dhe shfrytëzimin e resurseve financiare etj. Në veçanti është i rëndësishëm konflikti dhe dallimi në lidhje me mekanizmat, organizimin, menaxhimin dhe drejtimin e institucioneve të karakterit publik, përkatësisht si këto aspekte janë tani më të zhvilluara dhe funksionojnë mes organizatave qytetare, nga njëra anë, kurse si funksionojnë në sektorin publik për kulturë nga ana tjetër. Pyetjet të cilat u hapën në këtë drejtim e problematizuan përputhshmërinë dhe adaptimin e institucioneve ekzistuese publike në raport me kërkesat, nevojat aktuale, transformime të praktikave bashkëkohore kulturore – artistike.

Megjithatë, krahas problemeve të theksuara, përfaqësuesit e të dy sektorëve vërejnë edhe ekzistimin e përvojave dhe praktikave të suksesshme të bashkëpunimit i cili përmes modeleve të hapura të bashkëpunimit, menaxhimit dhe realizimit kolaborues të aktiviteteve kulturore të llojeve të ndryshme, kanë pasur lëvizje efektive në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit në të dyja anët.

Duke marrë parasysh problemet reale të identifikuar në raport me relacionin mes sektorit publik dhe skenës së pavarur, por edhe të përvojave pozitive të kolaborimit, si dhe shembujt nga Evropa dhe regjioni, Qyteti i Shkupit si qëllim të tij strategjik për katër vitet e ardhshme e paraqet zhvillimin dhe nxitjen e modelit të ri të organizimit të hapur kulturor të bazuar në principin e partneritetit publik – civil dhe modelit të përzier të udhëheqjes dhe menaxhimit. Zhvillimi i këtij modeli do të ketë për qëllim të ofrojë modele të mundshme alternative për zhvillimin dhe institucioneve edhe organizatave ekzistuese në fushën e kulturës (por edhe të veprimtarive dhe praktikave tjera shoqërore). Zhvillimi i modelit të hapur të organizimit kulturor është mundësi për qëndrueshmërinë e praktikave moderne kulturore dhe produksionit artistik në kontekst të skenës së pavarur kulturore, përmes ndihmës gjatë sigurimit të hapësirave dhe kushteve adekuate, por edhe për promovim të programeve dhe aktiviteteve të skenës së pavarur dhe rinore kulturore dhe artistike.

Në fund, zhvillimi i modelit të hapur të organizimit kulturor do të kontribuojë në promovimin e qytetit të Shkupit dhe kulturës së qytetit të Shkupit në nivel regional dhe internacional, përmes promovimit të risive dhe demokracisë në produksionin kulturor, si dhe përmes nxitjes dhe inkurajimit të lidhjes dhe partneritetit të skenës së pavarur kulturore dhe sektorit publik në nivel evropian.

Në kornizat e kësaj strategjie hap të nevojshëm do të paraqesë përfshirja e Ministrisë për kulturë dhe Agjencisë për të rinj dhe sport të Republikës së Maqedonisë.

Aktivitete:

- Formimi i grupit punues me përbërje të përzier, duke përfshirë përfaqësues nga Qyteti i Shkupit, institucionet kulturore dhe skena e pavarur kulturore dhe ekspertë të fushës;
- Përcaktimi i lokaliteteve të mundshme;
- Gjetja e modelit të organizimit (Aplikimi i përvojave komparative të modeleve ekzistuese, si për shembull në Holandë, Belgjikë, Kroaci etj.);
- Definimi i misionit dhe i përmbajtjeve programore të organizimit;
- Zgjedhja e bashkëpunëtorëve programor
- Përgatitja e draft planit aksionar;
- Përgatitja e programit dhe strategjisë vjetore të organizimit.

Korniza kohore: 2012 – 2015

QËLLIMI STRATEGJIK 8: Përgatitje dhe zbatim i programit edukativ për ngritjen e ndërgjegjes kulturore mes fëmijëve dhe të rinjve në qytet

Gjendje të identifikuar dhe përshkrim i qëllimit strategjik:

Vitet e fundit në Maqedoni nevoja për aktualizimin e kulturës dhe artit si dhe aktivitetet dhe çështjet nga fusha e të njëjtave, përkatësisht zhvillimi i prezantimit të

politikave kulturore, është më se e nevojshme. Ky problem vjen edhe më shumë në shprehje kur merret parasysh ngarkimi i hapësirës mediatike, i mbushur me pyetje në lidhje me politikën ditore dhe jeta publike i kuptuar në këtë kuptim të ngushtë. Kjo i ngushton burimet e mundshme të informacioneve nga fusha e kulturës dhe artit jashtë hapësirës zyrtare mediatike dhe i orienton drejt medimeve joformale të komunikimit, debatit dhe sjelljes së vendimeve. Nga ana tjetër, nisja e diskutimeve relevante akademike dhe profesionale është e kufizuar në sferën e definuar akademike institucionale, me çka të gjitha këto çështje bëhen pjesë e diskutimeve elitare dhe rretheve të mbyllura të individëve. Më tutje, shkëmbimi i informacioneve në lidhje me ngjarjet aktuale kulturore – artistike mbetet e mbyllur mes vizitorëve të rregullt të galerive dhe institucioneve kulturore, duke përfshirë edhe artistët, me çka sfera qytetare e pa aktivizuar sa duhet mbetet edhe më tutje e painformuar dhe e pa mobilizuar. Indikator më preciz për këtë vazhdon të jetë ende vizita e ultë e ekspozitave dhe ngjarjeve të tjera artistike nga ana e publikut gjeneral

Më tutje, kjo situatë reflektohet në masivizimin e qytetarëve kur është në pyetje pjesëmarrje e tyre në debatet kulturore bashkëkohore, në praktikat artistike dhe në sjelljen e vendimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për krijimin e politikave kulturore. Situata e këtillë krijon rreth të mbyllur, i cili në vend që të hapet drejt publikut më të gjerë, e veçanërisht drejt popullatës së re, edhe më shumë mbyllet në rrethin e njëjtë të individëve të etabluar.

Në fund, edhe krahas asaj se sa vjen e më shumë jemi dëshmitarë të inicimit të debateve TV, megjithatë me keqardhje mund të konstatojmë se të njëjtat kanë tema dhe çështje të kufizuara nga sfera politike.

Situata e tillë bëhet edhe më alarmante kur shqyrtohet konteksti i arsimit formal dhe joformal të arsimit të të rinjve në Maqedoni, përkatësisht qasja e tyre deri tek informacionet nga fusha e artit dhe kulturës, angazhimi dhe kontributi i tyre në produksionin kulturor dhe aktivizimin artistik, si dhe qasja e tyre drejt formave alternative të vetorganizimit të cilët si lëndë interesi do ta keni zhvillimin kulturor dhe debatimin dhe aktualizimin e pyetjeve nga fusha e artit, historisë së artit dhe historisë të artit kombëtar dhe rrjedhat bashkëkohore. Vlerësimi gjeneral është se po vërehet pasivizimi i të rinjve në kuptim të interesimit dhe kontributit të tyre aktiv drejt dhe në produksionin artistik dhe kulturor.

Duke marrë parasysh konstalacionin dhe pozicionin e këtillë të të rinjve, Qyteti i Shkupit ka për qëllim që të ndër marrë një sërë aktivitete dhe të amë të cilat do të kontribuojnë në nxitjen dhe avancimin e ndërgjegjes për kulturë dhe art mes të rinjve, me qëllim kyçjen e tyre më aktive në ngjarjet dhe nevojat kulturore dhe artistike në Qytet.

Aktivitete:

- Në bashkëpunim me Sektorin për arsim të Qytetit të Shkupit dhe komunave lokale, përgatitje të programit gjithëpërfshirës edukativ të destinuar për shkollat fillore dhe të mesme në Shkup. Programi do të jetë i destinuar për fëmijët dhe të rinjtë;
- Formimi i trupit profesional dhe këshillëdhënës nga të gjitha sferat e kulturës, për përgatitje komplekse të konceptit dhe (propozim) programit edukativ;
- Përgatitje dhe realizim të programeve për trajnim të ligjëruesve, arsimtarëve dhe profesorëve në çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme, në kontekst të kulturës modern, bashkëkohore dhe tradicionale. Ligjëruesit, arsimtarët dhe profesorët e trajnuar do ta zbatojnë edukimin e destinuar për fëmijë dhe të rinj
- Plan për zbatimin e programit dhe kohëzgjatjen e edukimit mes fëmijëve dhe të rinjve, në çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme.

Korniza kohore: 2012 - 2013

QËLLIMI STRATEGJIK 9: Rikonstruksion, riparim dhe mirëmbajtje e objekteve dhe enterierit të institucioneve kulturore, të themeluara nga Qyteti i Shkupit

Gjendje të identifikuar dhe përshkrim i qëllimit strategjik:

Me procesin e decentralizimit, Qyteti i Shkupit i ndërmori të drejtat themeluese të tetë institucioneve nga fusha e kulturës: IP Muzeu i Qytetit të Shkupit, IP QKF “Karposh”, IP QOM Salla universale, IP Qendra informative kulturore, IP Qendra kulturore rinore, IP Kopshti zoologjik, IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Miladinov” dhe IP Shtëpia e kulturës “Koço Racin”.

Duke marrë këtë kompetencë, Qyteti morri obligimin që të kujdeset për rikonstruksionin, riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të këtyre institucioneve. Në periudhën e njëjtë, Qyteti i Shkupit i shqyrtoi problemet dhe nevojat në këtë plan, bëri vlerësimin e gjendjes reale dhe gradualisht filloi me zgjidhjen e tyre. vitet e kaluara, në këtë drejtim janë realizuar këto projekte dhe aktivitete: a) Është kryer rikonstruksion i plotë eksterier dhe interier dhe ripërtëritje e objektit të QKR “Karposh” – monumenti i kulturës i kategorisë të lartë. Monumentit ju kthye pamja autentike, u furnizua me mobilie të reja për institucionin dhe pajisje të reja audio – vizuale; b) Në Qendrën informative kulturore, janë ripërtërirë dy sallone ekspozuese, tërësisht është rinovuar, ripërtërirë dhe pajuar (me teknike bashkëkohore), salla e Sallonit “19 19”; c) Në Qendrën kulturore rinore tërësisht është rinovuar fasada dhe është zëvendësuar kulmi i objektit, kurse në vijim është rikonstruksioni i enterierit në kornizat e të cilës është përfshirë edhe rinovimi i Sallës për vallëzim, e njëjta është pajisur edhe me pajisje teknike moderne dhe është rinovuar edhe lobi i Kinemasë të qytetit “Milenium”, e cila punon në kornizat e QKR. Për nevojat e kinemasë (për herë të parë në Maqedoni), janë blerë dhe instaluar pajisje 3D, për projektimin e filmave; ç) Në Kopshtin zoologjik janë ndërtuar vendbanime të reja për kafshët, është rinovuar një pjesë e vendbanimeve të vjetra, sipërfaqja e gjelbër është rregulluar nga ana hortikulturore etj.; d) Në Muzeun e Qytetit të Shkupit është adaptuar ambient i ri për ekspozim të përhershme të veprave të dhuruara nga piktori akademik Rodolub Anastasov, është rinovuar ambienti i Muzeut të Çarshisë të vjetër të Shkupit të vendosur në Suli Han, kurse gjatë vitit 2012 do të angazhohet ekspozim muzeal i pasuruar me eksponate të reja muzeale, janë përgatitur projekti për rikonstruksion të plotë të krahut perëndimor të objektit të Muzeut të qytetit të Shkupit; dh) Në Sallën universale bëhen intervenime të përhershme në enterierin e saj dhe deri tani janë sanuar nyjet sanitare, është adaptuar një pjesë e ambientit për realizimin e shfaqeve të orkestrave të dhomave dhe koncerteve etj.; e) Në Shtëpinë e kulturës “Koço Racin” gjatë vitit 2012 do të rinovohet një pjesë e ambientit të destinuar për veprimtari galerie; ë) Në Bibliotekën e qytetit “Vëllezërit Miladinov” gjatë këtij viti do të bëhet rikonstruksioni dhe rinovimi i konstruksionit të kulmit të objektit.

Duke vazhduar qëllimin strategjik të Qytetit të Shkupit për rikonstruksionin, riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të institucioneve kulturore në kompetencë të tij, për periudhën e ardhshme planifikohen këto aktivitete:

Aktivitete:

- Pajisje multimediale të institucioneve kulturore;
- Përgatitje e projektit për rikonstruksionin dhe riparimin e katit të fundit të Bibliotekës së qytetit “Vëllezërit Miladinov”;
- Renovim i njësisë organizative të Bibliotekës së qytetit “Vëllezërit Miladinov”;

- Realizim i projekteve për rikonstruksionin e krahut perëndimor të objektit të Muzeut të qytetit të Shkupit dhe fasadës së Muzeut;
- Ndërtim i vendbanimeve të reja në Kopshtin zoologjik;
- Ndërtim i kulmeve dhe rinovim i Shtëpisë të kulturës Koço Racin;
- Rikonstruksion i Sallës universale – Shkup;
- Rikonstruksion i Galerisë në Qendrën kulturore rinore;
- Ndërtim i objektit të llojit të hapur në formë amfiteatri i cili do të shërbejë për ngjarje kulturore dhe të tjera, me çka do të fitojë infrastrukturë të dobishme për manifestime muzikore dhe dramaturgjike dhe lloje tjera të programeve.

Korniza kohore: 2012 – 2015

PLAN AKSIONAR PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E KULTURËS 2012 – 2015

<p align="center">Qëllimi strategjik 1:</p>	<p>Zhvillimi i modelit pluralist dhe demokratik i politikës kulturore i Qytetit të Shkupit</p>
<p align="center">Aktivitete:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Modernizimi i mënyrës së financimit. - Zhvillimi i mekanizmave për realizimin e barazisë (ri) shpërndarjes së buxhetit për realizime në suazat e produksionit tradicional, modern dhe bashkëkohor kulturor. Krijimi i procedurës për përkrahje të barabartë dhe trajtim të kulturës moderne, bashkëkohore dhe tradicionale në Shkup. - Përkrahje e barabartë publike e produksionit modern, bashkëkohor dhe tradicional kulturor, promovim i trashëgimisë kulturore nëpërmjet

përkrahjes së projekteve nga turizmi kulturor; përkrahje e skenës kulturore të pavarur; përkrahje e kulturës amatore; përkrahje e kulturës rinore; bashkëpunim me institucionet kulturore; bashkëpunim me organizatat kulturore; bashkëpunim me bashkëpunëtor individual kulturor; kujdesi për infrastrukturën publike në suazat e kulturës dhe stimulimit të medimeve të reja dhe hulumtimit të kulturës; përkrahje e bashkëpunimeve ndërkombëtare).

- Vendosija e sistemit kualitativ operativ me kritere të precizuara saktë.
- Përcaktimi i kritereve për kulturën amatore (grupe fokus: amatorë/persona pa arsim formal artistik dhe pa pagimin e honorarëve dhe pa paga për veprimtarinë e tyre projektuese kreative; përkrahje e organizatave amatore kulturore të cilat termin /qëndrimin amator e kanë vërtetuar në qëllimet dhe detyrat e statutit të shoqatës /organizatës; persona dhe grupe të cilët merren me art di hobi). Në suazat e kulturës amatore do të përkrahen projektet kreative dhe edukative nga kategoritë e arteve interpretuese, arteve muzikore,

	<p>arteve vizuale, arkitekturë dhe dizajn, arti i medimeve të reja dhe literaturë/libër/albume strip/novelë grafike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i kriterëve për kulturën rinore (grupe fokus: fëmijë dhe të rinj; projekte të iniciuara nga fëmijë dhe të rinj nën autorësinë e personit të rritur, projekte artistike dhe kreative të destinuara për fëmijë dhe të rinj; kopshte, shkolla fillore, shkolla të mesme; nxitja dhe zhvillimi i kulturave dhe subkulturave rinore kulturore). Në suazat e kulturës rinore do të përkrahen projektet kreative dhe edukative nga kategoritë e arteve interpretuese, arteve muzikore, arteve vizuale, arteve të medimeve të reja dhe literaturë/libër/albume strip/novelë grafike. - Përcaktimi i kriterëve për zgjedhje, numër, mandat dhe obligime të komisioneve profesionale. - Formimi i komisioneve eksperte. - Përgatitja e rregullores.
Korniza kohore:	2012-2015
Bartës:	Sektori për veprimtari publike/ Seksioni për kulturë
Buxhet:	

<p>Qëllimi strategjik 2:</p>	<p>Transparencë, profesionalizëm dhe efikasitet në veprimin e kulturës në Qytetin e Shkupit</p>
<p>Aktivite:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i sërishëm i mënyrës për veprimtarinë transparente në kulturë në Qytetin e Shkupit, në institucionet kulturore, organizatat kulturore dhe punëtorët e kulturës; nëpërmjet konkursit publik dhe të arritshëm të të gjitha dokumenteve relevante të tipit: <ul style="list-style-type: none"> • Shpallja e konkurseve vjetore dhe rezultateve nga konkurset • Shpallje publike e komisioneve profesionale dhe kryetarëve të komisioneve • Shpallje publike e projekteve dhe programeve të miratuara në vitin në vijim • Shpallje publike e financave të veçanta për çdo projekt dhe program të miratuar • Shpallja publike e Strategjisë për kulturën e Qytetit të Shkupit me Planin aksionar, 2012 – 2015 - Realizimi i ndryshimeve në konkursin për programet dhe projektet vjetore, gjatë kësaj duhet të respektohen këto etapa: <ul style="list-style-type: none"> ○ Përcaktimi i rregullave dhe kritereve për paraqitjen e

projektit për fusha të veçanta

- Buxheti i destinuar për kulturën do të planifikohet në përputhje me projekte e paraqitura nga fusha të ndryshme sipas kritereve të përcaktuara më parë me rregullore

- Përkrahje e institucioneve të themeluara nga Qyteti i Shkupit

- Fusha të kulturës:

- Arte interpretuese
- Arte muzikore
- Arte vizuale
- Arte të medimeve të reja
- Veprimtari botuese
- Bibliotekari
- Kulturë rinore
- Kulturë amatore
- Turizëm kulturor dhe promocion i trashëgimisë kulturore
- Veprimtari muzeore
- Bashkëpunim ndërkombëtar
- Të përcaktohet kohëzgjatja e procesit të kontrollit, seleksionimit dhe zgjedhjes së projekteve. Të përcaktohen mënyra për

informimin e argumentuar dhe në kohë të grupeve dhe individëve për shkaqet për refuzimin dhe përkrahjen e projekteve të marra; të përcaktohen përmbajtja dhe koha për nënshkrimin e kontratave; të përcaktohen rregullat për realizimin e projekteve, të financuara nga ana e Qytetit të Shkupit.

- Bashkëpunimet ndërkombëtare të përfshijnë projekte bashkëpunimi, vizita dhe shfaqje të ndryshme publike, anëtarësi në rrjete dhe organizata të rëndësishme ndërkombëtare; anëtarësim i Qytetit të Shkupit në organizatat botërore kulturore dhe artistike, anëtarësi në rrjetëzimin ndërkombëtar.
- Çdo komision është mirë që të jetë i kombinuar – i përbërë nga bashkëpunëtorë të jashtëm dhe të brendshëm nga Qyteti i Shkupit; komisioni profesional të propozojë kryetarin; anëtarët e komisionit profesional do të paguhën me honorar dhe do të angazhohen sipas nevojës; çdo anëtar i komisionit do të veprojë për një periudhë të caktuar kohore /mandat; është e domosdoshme të formohen më shumë komisione profesionale veçanërisht për çdo fushë në kulturë:

- Komisioni për veprimtarinë profesionale, amatore dhe rinore në fushën e arteve vizuale të medimeve të reja
 - Komisioni për veprimtarinë profesionale, amatore dhe rinore në fushën e arteve interpretuese
 - Komisioni për veprimtarinë profesionale, amatore dhe rinore në fushën e arteve muzikore
 - Komisioni për veprimtarinë profesionale, amatore dhe rinore në fushën e arteve botuese dhe bibliotekare
 - Komisioni profesional për bashkëpunim ndërkombëtar
 - Komisioni për veprimtarinë profesionale, amatore dhe rinore në fushën e turizmit kulturor për promovimin e trashëgimisë kulturore
- Trajnimi i të punësuarve në Qytetin e Shkupit, për veprimtarinë efikase dhe bashkëpunimin në suazat e kulturës dhe nevojave aktuale të saj, trendëve, rrjedhave dhe përdorimit të teknologjive të reja.
 - Përgatitja e platformave gjithëpërfshirëse-informatike digjitale në kulturë. (Sipas

shembullit na www.culture.si, www.culture.uk, www.culture.de ... përgatitja e këtij tipi platformash digjitale do të zgjidhin problemin e deficitit informativ të qytetarëve, punëtorëve të kulturës nga vendi, regjioni Evropa dhe bota – të cilët iniciojnë bashkëpunim kulturor me /në Maqedoni, sepse ato do të mundësojnë shqyrtimin e informacioneve për trashëgiminë kulturore lokale, moderne dhe artistike, turizmin kulturor, gastronominë; jetën shoqërore, kulturore, ekonomike dhe politike në vendin tonë, në një hapësirë funksionale digjitale me të dhëna informatike dhe digjitale të arritshme).

- Krijimi i mekanizmave për bashkëpunim në kontinuitet ndërmjet Sektorit për veprimtari publike / Seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe medimeve; për përgjegjësinë e tyre mediatike dhe përfshirjen e tyre në proceset e veprimtarisë së Sektorit për veprimtari publike / seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit.
- Përgatitja e një rregulloreje të vetme.
- Përgatitja e Strategjisë për zhvillim kulturor të Qytetit të Shkupit për periudhën 2015 – 2020.

Korniza kohore:	2012 – 2013
Bartës:	Qyteti i Shkupit Sektorit për veprimtari publike / Seksionit për kulturë/Sektori për zhvillim ekonomik lokal.
Buxhet:	

Qëllimi strategjik 3:	Zhvillimi i modelit efikas për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ndryshme, institucioneve, organizatave, seksioneve, sektorëve dhe aktorëve nga fusha e kulturës në Qytetin e Shkupit
Aktivitete:	<ul style="list-style-type: none"> - Institucionet kulturore të Qytetit të Shkupit të përgatisin strategjitë e veta për kulturë 2013-2016. - Përgatitja obliguese e ueb-faqeve nga ana e institucioneve kulturore, qartësinë e tyre, mirëmbajtjen në kontinuitet dhe azhurnimin dhe plotësimin. - Shqyrtimi i zhvillimeve të përbashkëta në mënyra të ndryshme për stimulimin e bashkëpunime të përbashkëta me organizatat kulturore të pavarura, në suazat e proceseve dhe nevojave të skenës kulturore në qytet. - Përkrahje e iniciativave për shqyrtimin e të gjitha kombinacioneve inventive të mundshme për lidhje partneriteti dhe bashkëpunimit gjatë realizimit të projeksioneve të ndryshme dhe progresive në kontekste lokale,

regionale dhe ndërkombëtare,

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet Sektorit për veprimtari publike / seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit nëpërmjet gjetjes së përbashkët të modeleve të partneritetit të mundshme për realizimin e projekteve të rëndësishme dhe afatgjata dhe projekte të tjera kolaborative me karakter lokal dhe ndërkombëtar.
- Ridefinim i bashkëpunimit dhe obligimeve mes Sektorit për veprimtari publike/seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe komunave lokale (seksione për kulturë dhe arsim).
- Ridefinim i bashkëpunimit dhe obligimeve mes (Sektorit për veprimtari publike/seksionit për kulturë) Qytetit të Shkupit dhe Ministrisë për kulturë.
- Ridefinim i bashkëpunimit mes Sektorit për veprimtari publike/seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit dhe medimeve.
- Përkrahje e bashkëpunimit ndërkombëtar në kulturë. Hap të rëndësishëm në kontekst të këtyre aktiviteteve paraqesin: stimulimi dhe përkrahja e bashkëpunimeve të ndryshme ndërkombëtare, përkrahja e projekteve kulturore dhe edukative të kofinancuara nga

	<p>fondet e UE dhe nga fondacione tjera evropiane/botërore, stimulim i projekteve në partneritet. Realizim i iniciativave për hyrje në rrjete të ndryshme dhe anëtarësim ndërkombëtar të Qytetit të Shkupit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxitje e zhvillimit të mekanizmave dhe moduleve efikase për realizimin e partneriteteve publike – private në kulturë dhe partneriteteve publike – civile, partneriteteve civile – private. - Zhvillim i mekanizmave dhe modeleve të cilat do të mundësojnë promovim të trashëgimisë kulturore të Qytetit të Shkupit përmes turizmit kulturor.
Korniza kohore:	2012 – 2015
Bartës:	Qyteti i Shkupit / Sektori për veprimtari publike/ Seksioni për kulturë / Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar/ Institucionet nga fusha e kulturës të Qytetit të Shkupit/ Shoqata qytetare nga fusha e kulturës
Buxheti:	

Qëllimi strategjik 4:	Iniciativa për ridefinimin e kornizës ligjore kombëtare në fushën e kulturës në përputhje me nevojat bashkëkohore të kulturës dhe punëtorëve në kulturë
Aktivitete:	<ul style="list-style-type: none"> - Gjetja e qasjes dhe modelit të bashkëpunimit me Ministrinë për kulturë në fushën e kornizës ligjore në kulturë. - Analizë, plotësim, rekomandim dhe

	<p>përfaqësim për zbatimin e plotësimeve/ndryshimeve në Ligjin për kulturë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizë, plotësim, rekomandim dhe përfaqësim në plotësimin/ndryshimin në Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publik. - Analizë, plotësim, rekomandim dhe përfaqësim për plotësimin/ndryshimin në Ligjin për shpalljen e çarshisë të vjetër të Shkupit për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë. - Analizë, plotësim, rekomandim dhe përfaqësim për plotësimin/ndryshimin në Ligjin për punë biblioteksite.
Korniza kohore:	2012 - 2015
Bartës:	Spektori për veprimtari publike/Seksioni për kulturë
Buxheti:	

Qëllimi strategjik 5:	Zhvillim i mekanizmave dhe moduleve efikase për shfrytëzimin e ambientit publik / ambientit të hapur në kulturë
Aktivitete:	<ul style="list-style-type: none"> - Hapje dhe adaptim të ambienteve publike me qëllim nxitjen e kreativitetit dhe dinamikës kulturore.

	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitje dhe realizim të projektit <i>Evidentim i qytetit të Shkupit</i> (Evidentim dhe analizë e lokaliteteve të qytetit: të braktisur a/të lëna pas dore, ambiente dhe objekte të padefinuara nga ana juridike nëpër Shkup dhe rrethinën e saj / komunat lokale). (01 – 12. 2013) - Përgatitje e konceptit/projektit/planit për realizimin e projektit trienal/kuadrienal me titull pune <i>Veshje e Shkupit</i>. (01- 12. 2014) - Plotësimi i rregullores ekzistuese për shfrytëzimin e ambientit publik të Sektorit për punë komunale. (10 – 12. 2013)
Korniza kohore:	2013 – 2015
Bartës:	Sektorit për veprimtari publike / Seksioni për kulturë / Sektorit për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës / Sektorit për punë komunale
Buxheti:	

Qëllimi strategjik 6:	Nxitje e zhvillimit të industrive kreative
Aktivitete:	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i Qendrës për industri kreative të realizohet në kornizat e planit katër vjeçar . (2011-2015) - Aktivitetet e Qendrës për industri kreative, do të realizohen në kornizat e festivalit SHKUPI KREATIV

	<p>(2012-2015)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hulumtim. (2011-2015) - Përgatitje e planit punues dhe financiar. (2012-2015) - Sigurim i hapësirave. (06-12.2013) - Menaxhim i hapësirës dhe programeve. (2013-2015) - Stimulim i projekteve multimediale. (2012-2015)
Korniza kohore:	2011 – 2015
Bartës:	Spektori për veprimtari publike / Seksioni për kulturë
Buxheti:	

Qëllimi strategjik 7:	Nxitje dhe zhvillim i modelit të ri të organizimit të hapur kulturor si servis për shoqatat nga fusha e kulturës dhe artistët e pavarur
Aktivitete:	<ul style="list-style-type: none"> - Formim i grupit punues me përbërje të përzier, duke përfshirë përfaqësues të Qytetit të Shkupit, institucionet kulturore publike dhe skenën e pavarur kulturore dhe ekspertë të fushës. - Përcaktim i lokaliteteve të mundshme. - Përgatitje e modelit të organizimit (Aplikim i përvojave komparative të modeleve ekzistuese, si për shembull në Holandë, Belgjikë, Kroaci etj.).

	<ul style="list-style-type: none"> - Definim i misionit dhe i përmbajtjes programore të organizatës. - Zgjedhje e bashkëpunëtorëve programor. - Përgatitje e draft planit aksionar. - Përgatitje e programit dhe strategjisë vjetore të organizatës.
Korniza kohore:	2012 – 2015
Bartës:	Sektori për veprimtari publike / Seksioni për kulturë /Shoqata të qytetarëve të përkrahura nga Qyteti të Shkupit
Buxheti:	

Qëllimi strategjik 8:	Përgatitje dhe realizim i programit edukativ për ngritjen e ndërgjegjes kulturore mes fëmijëve dhe të rinjve në qytet
Aktivitete:	<ul style="list-style-type: none"> - Në bashkëpunim me sektorin për arsim të Qytetit të Shkupit dhe komunave lokale, përgatitje e programit gjithëpërfshirës edukativ, të destinuar për shkollat fillore dhe të mesme në Shkup. - Formim i trupit profesional dhe ligdhënës të të gjitha territoreve të kulturës, për përgatitje komplekse të konceptit dhe (propozim) programit edukativ.

	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitje dhe realizim i programeve për trajnim të ligjëruesve, arsimtarëve dhe profesorëve në çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme, në kontekst të kulturës moderne, bashkëkohore dhe tradicionale. - Plan për realizimin e programit dhe kohëzgjatjes së edukimit mes fëmijëve dhe të rinjve, në çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme.
Korniza kohore:	2012 - 2013
Bartës:	Sektori për veprimtari publike / Seksioni për kulturë /Sektori për arsim/Shkollat fillore dhe të mesme në territorin e Qytetit të Shkupit
Buxheti:	

Qëllimi strategjik 9:	Rikonstrukcion, ripërtëritje dhe mirëmbajtje e objekteve dhe enterierit të institucioneve kulturore të themeluara nga Qyteti i Shkupit
Aktivitete:	<ul style="list-style-type: none"> - Pajisje multimediale të institucioneve kulturore. - Përgatitje e projektit për rikonstrukcionin dhe ndërtimin e katit të fundit të Bibliotekës së qytetit “Vëllezërit Miladinov” - Rinovim i njësive organizative të Bibliotekës së qytetit Vëllezërit

	<p>Miladinov</p> <ul style="list-style-type: none"> - Realizim i projekteve për rikonstruksionin e krahut perëndimor të objektit të Muzeut të Qytetit të Shkupit dhe fasadës së Muzeut - Ndërtim i vendbanimeve të reja në Kopshtin zoologjik. - Ndërtim i çatave dhe rinovim i Shtëpisë të kulturës Koço Racin. - Rikonstruksion i Sallës universale - Shkup. - Rikonstruksion i Galerisë në Qendrën kulturore rinore - Ndërtim i objektit të llojit të hapur në formë amfiteatri i cili do të kishte për qëllim evenimentet kulturore dhe të tjera, me çka do të fitohet infrastrukturë e dobishme për manifestime muzikore dhe dramaturgjike dhe për lloje tjera programesh.
Korniza kohore:	2012 – 2015
Bartës:	Sektori për veprimtari publike / Seksioni për kulturë / Institucionet nga fusha e kulturës të Qytetit të Shkupit/Drejtoria për mbrojtjen e monumenteve/Qendra konservatore – Shkup
Buxheti:	

PËRMBLEDHJE

Strategjia për zhvillimin e kulturës të Qytetit të Shkupit 2011-2014 përbën rezultat të qasjes integrale metodologjike që përfshin metoda kuantitative dhe kualitative, si dhe analiza të marra nga dy qasjet metodologjike. Metodatat që përbëjnë bazën e përgatitjes së dokumentit final përfshijnë analiza të shumë programeve ekzistuese për kulturën e Qytetit të Shkupit dhe buxhete për pesë vitet e kaluara, dhe realizojnë një seri anketash dhe intervistë me aktorë të ndryshëm, si institucionet kulturore në territorin e Qytetit të Shkupit, komunat në Qytetin e Shkupit, organizatat civile, ekspertë nga fusha e kulturës, menaxhmenti kulturor dhe politikatat kulturore, por edhe grupet fokus me punëtorë të kulturës dhe ekspertë, si dhe dy debate publike.

Informacionet kulturore dhe të dhënat që janë grumbulluar në procesin hulumtues, ka për qëllim të japin një pamje të vërtetë në situatën ekzistuese në terren, problemet dhe nevojat e aktorëve të ndryshëm në sektorin e kulturës në territorin e qytetit të Shkupit, dobësitë tyre, rreziqet në realizimin e vizioneve dhe misioneve, evidentimin e eksperiencave pozitive, kapaciteteve, mundësive dhe dobësive mbi bazën e të cilave mund të zhvillohen qëllime afatgjata dhe aktivitete, si dhe propozime të tyre konkrete dhe drejtime për përcaktimin e Strategjisë.

Depozitë të rëndësishme të veçantë në procesin e përgatitjes së Strategjisë përbëjnë debatet publike që bashkuan përfaqësues të institucioneve dhe sektorëve publik, nga njëra anë, dhe përfaqësues nga skena e pavarur kulturore, nga ana tjetër, si dhe ekspertë të pavarur angazhimi i të cilëve në kulturë përbënte një sfond eksperience i cili çonte drejt diskutimit të frytshëm dhe propozimeve konkrete. Problemet që u identifikuan si kryesore në procesin e debatit publik, dhe që u paraqitën konkretisht edhe nëpërmjet intervistave individuale dhe grupeve fokus të realizuara, si dhe të induktuara nëpërmjet analizës së anketave të realizuara dhe programeve ekzistuese dhe aktiviteteve në nivel të Qytetit të Shkupit, përfshijnë disa sfera të ndryshme, por të pakompletuara të veprimit në dhe menaxhimit e kulturës dhe politikave kulturore:

➤ Dominimi i modelit ekzistues të drejtimit të kulturës i cili:

- Kufizon frekuencën e produksionit të konkurrencës bashkëkohore kulturore-artistike, produksionin dhe vazhdimësinë në suazat e veprimit bashkëkohor në kulturën e Qytetit të Shkupit, nga njëra anë, dhe

- Pengon zhvillimin e modelit civil të bazuar në drejtimin e politikës kulturore që do të ndjekë, përkundër nevojave të bashkësive të ndryshme etnike, nevojave dhe specifikave të bashkësive të marginalizuara dhe bashkësive të tjera në qytet, pikërisht realizimit të kulturës pluraliste të përcaktuar mbi bazën e përcaktimeve gjeografike dhe territoriale:

➤ Nevoja e rritjes dhe fuqizimit të mekanizmave të transparencës gjatë sjelljes së vendimeve dhe politikave, distribucionit të resurseve financiare dhe bashkëpunimit të Qytetit të Shkupit me aktorët e tjerë të kulturës në qytet, si dhe transparencë në institucionet kulturore.

➤ Nevoja për zhvillimin e strategjisë efikase dhe mekanizmave të bashkëpunimit me mediumet në nivel lokal dhe nacional.

➤ Mungesa e legjislacionit, koordinimi i qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm në kulturë në territorin e Qytetit të Shkupit, si dhe zhvillimi i pamjaftueshëm, stimulimi dhe efektiviteti i bashkëpunimit ndërkombëtar.

➤ Pengesa në seri me të cilat ballafaqohen aktorët në kulturë në punën e përditshme, menaxhimit, hulumtimit dhe produksionin, të cilët si faktor të drejtpërdrejtë paraqesin nyjat e ndryshme dhe mungesat në legjislacionin ekzistues.

- Praktika të pazhvilluara plotësisht dhe kapacitete të Qytetit të Shkupit dhe sektorit civil për lotimin e përbashkët dhe përfaqësimin dhe qasjen proaktive në relacionin me bartësit e vendimeve.
- Hulumtimi i pamjaftueshëm i kulturës, funksionalizimi i sërishëm artistik dhe kreativ dhe shfrytëzimi i hapësirës publike në Shkup, si mundësi për produksionin kulturor dhe artistik.
- Mungesa e kontrollit të evidentuar të hapësirave publike ekzistuese dhe në dispozicion dhe objekteve nën kompetencat e Qytetit dhe shtetit, në territorin e qytetit të Shkupit.
- Mungesa e përcaktimit të strategjisë në nivel lokal për zhvillim në projekt konkret për nevojën e investimit në ato degë ekonomike që japin dobi më të madhe ekonomike, pikërisht për zhvillimin e industrive kreative.
- Mungesa e hapësirave, resurseve dhe kushteve për realizimin e aktiviteteve me karakter bashkëkohor-artistik nga ana e skenës së pavarur kulturore.
- Pozicione konfliktuoze ndërmjet sektorit të pavarur kulturor dhe institucioneve publike nga fusha e kulturës, pikërisht të nyjave të dendura në mundësinë për dialog, bashkëpunimit, zhvillimit të partneritetit, forma të menaxhimit, mospajtime programore, konflikte në shpërndarjen dhe shfrytëzimin e resurseve publike financiare etj.
- Problematizimi i adaptimit të institucioneve ekzistuese publike në lidhje me kërkesat aktuale, nevojave, transformimeve të praktikave bashkëkohore kulturore–artistike dhe modeleve të menaxhimit dhe drejtimit të organizatave.
- Pragu i ulët i vetëdijes kulturore ndërmjet të rinjve, si dhe qasje e pazhvilluar sa duhet deri te informacionet nga fusha e artit dhe kulturës, angazhimi relativisht pasiv dhe kontributi i produksionit dhe aktivizimit artistik.
- Vjetërsia, efikasiteti i dobët dhe disponimi minimal me materiale, teknika dhe resurse logjistike i institucioneve nën kompetencat e Qytetit të Shkupit.

Duke pasur parasysh të gjitha problemet e identifikuar më lart, si dhe potencialin për përmirësimin e tyre, përkatësisht zgjidhjen, u zhvilluan dhe përpunuan me aktivitete specifike nëntë qëllime themelore strategjike:

1. Zhvillimi i modelit pluralist dhe demokratik i politikave kulturore të Qytetit të Shkupit,
2. Transparenca, profesionalizmi dhe efikasiteti në veprimin e kulturës në qytetin e Shkupit,
3. Zhvillimi i modelit efikas për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ndryshme, institucioneve, organizatave, seksioneve, sektorëve dhe aktorëve nga fusha e kulturës në Qytetin e Shkupit,
4. Inicimi i analizave dhe përfaqësime për ripërcaktimin e kornizës nacionale në fushën e kulturës në përputhje me nevojat bashkëkohore të kulturës dhe punëtorëve të kulturës,
5. Zhvillimi i mekanizmave efikas dhe modeleve për përdorimin e hapësirës publike/ të hapur në kulturë,
6. Nxitja dhe zhvillimi i industrive kreative,
7. Nxitja dhe zhvillimi i modelit të ri organizatës së hapur kulturore si servil për shoqatat nga fusha e kulturës dhe artistëve të pavarur

8. Krijimi dhe realizimi i programit edukativ për ngritjen e vetëdijes kulturore ndërmjet të rinjve në qytet dhe

9. Rikonstruksioni, rinovimi dhe mirëmbajtja e objekteve të institucioneve kulturore të themeluara nga Qyteti i Shkupit.

Strategjia me plan aksionar për zhvillimin e kulturës të Qytetit të Shkupit do të shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit, Sektori për veprimtari publike, Seksioni i kulturës.

Të gjitha rezultatet e arritura nga realizimi i Strategjisë për zhvillimin e kulturës të Qytetit të Shkupit 2012-2015, do të jenë pjesë e rregullores së destinuar për përdorim nga të gjitha punëtorët e kulturës, institucioneve, organizatave, etj. Rregullorja do të jetë në dispozicion në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit.

METODOLOGJIA DHE PROCEDURA

Kjo pjesë e Strategjisë me plan aksionar për zhvillimin e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për periudhën 2012 – 2015 (në tekstin e mëtejshëm: Strategjia) përmban përshkrimin e procedurave dhe metodologjisë, të shfrytëzuara të aktiviteteve të parashikuara në përgatitjen e Strategjisë.

Formimi i ekipit për përgatitjen e Strategjisë:

Ekipi i Institutit për hulumtime shoqërore dhe humaniste „Euro-Balkan“, që punoi për përgatitjen e Strategjisë, përbëhej nga:

Mr. Sllavčo Dimitrov – Drejtor i Seksionit për hulumtime vizuale dhe kulturore
Dr. Ivanka Apostolova – Bashkëpunëtor shkencor / Docent
Mr. Bojana Janeva Shemova – Bashkëpunëtor hulumtues / Koordinator
Mr. Viktorija Borovska – Bashkëpunëtor hulumtues / Koordinator
Dr. Vesna Matijasheviq Pokulec – Profesor i rregullt / Këshilltar shkencor
Mr. Biljana Tanurovka Qulavkovski – Menaxherë për kulturë dhe art, OJQ Lokomotiva nga Shkupi (Konsultues i jashtëm dhe anëtar i ekipit)

Korniza metodologjike:

Metodologjia për hulumtimin dhe përgatitjen e Strategjisë shfrytëzoi metoda kualitative dhe kuantitative. Kombinimi i dalë nga kjo qasje e integruar metodologjike përfshin dobitë edhe nga qasja kuantitative dhe kualitative.

Qasja e integruar metodologjike përfshin këto metoda dhe procedura:

- Identifikimi i institucioneve, qendrave kulturore, shoqatave civile, nga fusha e kulturës;
- Anketa me komunitat që gjenden në territorin e qytetit të Shkupit;
- Anketa me institucionet kulturore nga Qyteti i Shkupit;
- Anketa me organizata të pavarura civile (OJQ) që punojnë në fushën e kulturës;
- Intervista gjysmë të strukturuar me persona profesional nga sektori publik dhe sektori joqeveritar nga fusha e kulturës (të marra nëpërmjet aktivitetit paraprak);
- Debate publike të organizuara për përcaktimin e vizionit. Analiza dhe sinteza e eksperiencave të ndara, qëllimeve, propozimeve dhe nevojave të personave profesional dhe bashkëpunëtorëve nga fusha e kulturës;
- Organizim i dy grupeve fokus për sintezën e të dhënave dhe reflekset e fituara me anë të procedurave të dhëna metodologjike;
- Analizë të raporteve dhe programeve vjetore të Seksionit për kulturë të Qytetit të Shkupit;
- Analizë të të dhënave të fituara nga qasja e integruar metodologjike;
- Përgatitje e draft strategjisë për kulturë të Qytetit të Shkupi.

Përgatitje e strategjisë me plan aksionar për zhvillim të kulturës me interes të Qytetit të Shkupit për periudhën 2012-2015, e realizuar përmes këtyre aktiviteteve:

- Përgatitje e pyetësorëve anketues për njësitë e vetëqeverisjes lokale nga qyteti i Shkupit;
- Përgatitje e pyetësorëve anketues për institucionet kulturore të Qytetit të Shkupit dhe organizata joqeveritare (OJQ) të cilat punojnë në fushën e kulturës;
- Përgatitje e udhëzuesit për intervista gjysmë të strukturuar me persona profesional nga sektori publik dhe joqeveritar, nga fusha e kulturës;
- Distribucion i pyetësorëve. Pyetësorët u distribuuan me anë elektronike, para së cilës kishte bisedë informative telefonike me personat përgjegjës të institucioneve dhe informim i tyre me qëllimet dhe idetë për përgatitjen e strategjisë për kulturë të Qytetit të Shkupit;
- Realizim i intervistave gjysmë të strukturuar, përmbledhje e tyre. Intervistat u zhvilluan nga ana e intervistuesve me përvojë dhe njohës të sferës së kulturës të Qytetit të Shkupit;
- Evidentim dhe analizë e pyetësorëve të përgjigjur nga ana e komunave, institucioneve kulturore dhe organizatave joqeveritare nga fusha e kulturës. Ekipi i Institutit “Euro – Ballkan” mbante evidencë për pyetësorët e plotësuar dhe të pakthyer dhe përpiquej me ngulim për përgjigje, përmes komunikimit të shpeshtë me institucionet e dhëna, me qëllim që të fitojë numër relevant të pyetësorëve të përgjigjur. Nga gjithsej dhjetë komuna, gjashtë i dërguan pyetësorët anketues të përgjigjur (Komunat: Çair, Shuto Orizar, Karposh dhe Saraj nuk ju përgjigjën anketës). Të gjitha tetë institucionet nga fusha e kulturës të Qytetit të Shkupit i kthyen pyetësorët e përgjigjur. Në pyetësorët për organizatat joqeveritare nga fusha e kulturës, u përgjigjën gjithsej 11 organizata. U realizuan gjithsej 6 intervista gjysmë të strukturuar edhe atë me:
 1. Viktorija Rangelova (Dramaturg i pavarur dhe skriptshkrues për Fondin e filmit të Maqedonisë),
 2. Mira Gaqina (Ciceron në I.K. Muzeu për art bashkëkohor, Shkup),
 3. Slobodan Unkovski (Regjisor teatri),
 4. Svetlana Axhigogova (Drejtuese e seksionit për kulturë të komunës Kisella Voda),
 5. Xvezda Angellovska (aktore dhe regjisore),
 6. Biljana Koçishka, (bibliotekist, Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Miladinov”)

- Analiza e të dhënave dhe informacioneve të mbledhura përmes pyetësorëve dhe intervistave. Të dhënat e fituara u analizuan përmes analizës kuantitative – kualitative. Të njëjtat shërbyen për zhvillimin e konceptit për debatin e parë publik.
- Përgatitja e konceptit për debatin e parë publik.
- Distribuim i ftesave dhe konceptit të personave profesional nga fusha e kulturës.
- Organizim dhe realizim i debatit të parë publik. Debati i parë publik u realizua më datë 25.11.2011. Në debat ishin të pranishëm 36 individë, ekspertë nga fusha e kulturës. Debati publik i incizua dhe në bazë të materialit të tillë u përgatit analiza dhe konkluzionet. Raporti nga debati i parë publik u dërgua deri te Qyteti i Shkupit dhe pjesëmarrësit në debat.

Temat për diskutim në debatin e parë publik ishin këto:

1. Politika kulturore e Qytetit të Shkupit;
2. Shfrytëzimi i ambientit publik;
3. Partneriteti publik-privat/publik-civil;
4. Përkrahje e barabartë përmes konkurseve të Qytetit të Shkupit dhe komunave lokale – mekanizmat e mundshme;
5. Përvoja, nevoja dhe mundësi për hulumtime nga fusha e kulturës.
6. Përkrahje dhe subvencionim i drejtë financiar i sektorit të pavarur në kulturë/art;

7. Bashkëpunim mes Qytetit të Shkupit, komunave lokale, institucioneve nga kultura, organizatat e pavarura, institucionet kombëtare;
8. Përvoja, nevoja dhe mundësi për hulumtim nga fusha e kulturës;
9. Demokraci kulturore ose demokratizim i kulturës si term dhe drejtim i politikës kulturore;
10. Platforma të përgjithshme dhe të gjera informuese digjitale.

Në debatin e parë publik morën pjesë:

1. Robert Allagjovovski, OJQ „Esperanca“
2. Vasilka Dimitrovska, Turizëm kulturor
3. Dejan Spasoviq, Pakt
4. Ivan Mirkovski
5. Pançe Vellkov, Makedonika
6. Ljubica Kondijanova, Muzeu i Qytetit të Shkupit
2. Antoaneta Shtefançiq, Qyteti i Shkupit
3. Renata Mateska, gazetare në TVM
4. Metodi Çilimanov, Qendra për arsim të të rriturve
5. Jordanço Milloshevski, ZOO Shkup
6. Tatjana Stamenov, ZOO Shkup
7. Marija S. Gjorgova, Ministria për kulturë e RM,
8. Velimir Zhernovski, Frik – Shkup
9. Biljana Tanurovska – Qullavkovski, Llokomotiva – Shkup,
10. Violeta Kaçakova, Llokomotiva - Shkup
11. Filip Jovanovski, Akto festivali
12. Gjorqe Jovanoviq, artist
13. Iskra Geshovska, Kontapukt
14. Elena Veljanovska, Line and Initiative
15. Violeta Kaliq Krstiq, Shtëpia e kulturës „Koço Racin“ – Shkup
16. Sadri Jakupi, Shtëpia e kulturës „Koço Racin“ – Shkup
17. Jelena Pejanoviq, Komuna Aerodrom
18. Biljana Koçovska Todorovska, Komuna Aerodrom
19. Gordana Andreeva, Biblioteka e qytetit „Vëllezërit Miladinov“
20. Biljana Koçishka, Biblioteka e qytetit „Vëllezërit Miladinov“
21. Gordana Haxhi-Nikollova, QIK Shkup
22. Emilia Mihajlova, QIP Shkup
23. Sillobodanka Stevçevska, Opa-artist
24. Biljana Radinovska, Theatra
25. Marija Zafirova, Theatra
26. Irina Kostovska, QKF Karposh
27. Gorjan Gashev, Qyteti i Shkupit
28. Atanas Botev, Muzeu i Qytetit të Shkupit
29. Petar Giçarovski, Qyteti i Shkupit
30. Miroslav Ivanoviq, Salla Universale
31. Vera Boshkoviq, Drejtoreshë e Sallës universale

- Përgatitje e konceptit për debatin e dytë publik.

- Distribucion i ftesave dhe konceptit për debatin e dytë publik të personave profesional të fushës së kulturës.

- Organizim dhe realizim i debatit të dytë publik. Debatit i dytë publik u mbajt më datë 26.12.2011. Në debat ishin të pranishëm 15 persona, ekspertë nga fusha e kulturës. Debatit u incizua dhe në bazë të këtij materiali u përgatit analiza dhe konkluzionet. Raporti nga debati i dytë publik u dërgua deri tek Qyteti i Shkupit dhe pjesëmarrësit në debat.

Temat për diskutim në debatin e dytë publik ishin këto:

- 1.Politika kulturore e Qytetit të Shkupit;
- 2.Shfrytëzimi i ambientit publik;
- 3.Partneritete publike-private/publike-civile;
- 4.Përkrahje e barabartë financiare përmes konkurseve të Qytetit të Shkupit dhe komunave lokale – mekanizmat e mundshme;
- 5.Përvoja, nevoja dhe mundësi për hulumtime nga fusha e kulturës.

Në debatin e dytë publik morën pjesë:

- 1.Nikolla Uzunovski, artist
- 2.Filip Jovanovski, Akto
- 3.Vasilika Dimitrovska, Turizmi kulturor
- 4.Tatjana Peroviq-Mitrova, SKTM
- 5.Iskra Geshovska, Kontrapukt
- 6.Biljana Tanurovska Qullavkovski, Llokomotiva
- 7.Violeta Kaçakova, Llokomotiva
- 8.Violeta Kaliq Krstiq, Shtëpia e kulturës “Koço Racin” – Shkup
- 9.Emilia Mihajlova, QIK
- 10.Juljana Temellkova, Biblioteka e qytetit „Vëllezërit Miladinov“
- 11.Mirjana Çupiq, Qyteti i Shkupit, Seksioni për punë profesionale
- 12.Lloven Markiq, Qyteti i Shkupit, Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar
- 13.Velimir Zhernovski, Frik – Shkup

- Përgatitja e konceptit për grupin e parë në fokus. Pas analizës së informacioneve dhe të dhënave të fituara me anë të pyetësorëve, intervistave dhe debateve të zhvilluara publike, ekipi i Euro – Ballkan, në marrëveshje me kompetentët në Qytetin e Shkupit, vendosi të organizojë dy grupe fokus për punë për sintetizimin e konkluzioneve të fituar.

- Ekipi i Institutit “Euro-Ballkan” bëri plan për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të grupeve fokus.

- Përgatitje e konceptit-udhëzues për grupet fokus.

- Realizim i grupeve fokus. Grupi i parë punues në fokus u realizua më datë 20.02.2012. Grupin fokus e moderoi mr. Sllavčo Dimitrov. Grupi i dytë punues në fokus u realizua më datë 21.02.2012. Grupin fokus e moderoi dr. Ivanka Apostollova. Në grupin e parë në fokus fokus, nga dhjetë bashkëpunëtorët e ftuar, të gjithë ishin të pranishëm. Në grupin e dytë në fokus, ishin të pranishëm vetëm tre nga të ftuarit. Grupet fokus ishin të karakterit të përzier: individë të cilit veprojnë vetëm në kulturë, përfaqësues nga Qyteti i Shkupit, përfaqësues nga sektori i pavarur kulturor në Shkup dhe përfaqësues nga institucionet kulturore të Shkupit.

Në grupin e parë në fokus morën pjesë:

- 1.Iskra Geshovska, Kontrapukt
- 2.Elena Veljanovska, Line and Initiative
- 3.Petar Giçarovski, Qyteti i Shkupit
- 4.Jane Çallovski, Press to Exit
- 5/Safet Kamberi, Shtëpia e kulturës „Koço Racin“ – Shkup
- 6.Ramadan Ramadani, Iisma
- 7.Filip Jovanovski, Akto

Në grupin e dytë punues në fokus morën pjesë:

- 1.Vasilika Dimitrovska, Turizëm kulturor
- 2.Robert Allagjozovski, OJQ „Esperanca“
- 3.Mirko Popov, PMG- recordings

- Analiza e grupeve punuese në fokus. Analiza e grupeve punuese në fokus u realizua mbi bazë të incizimeve të dy grupeve në fokus.

- Konceptimi i strategjisë për kulturë. Pas realizimit të aktiviteteve të shënuara dhe analizës së dokumentacionit të plotë nga realizimi i aktiviteteve dhe përvojave të fituara përgjatë procesit, ekipi i Institutit “Euro – Ballkan”, mbajti një sërë takimesh dhe konsultimesh me konsulentin dhe me ekipin e Qytetit të Shkupit, me qëllim që të bëhet një koncept punues për strategjinë për kulturë.

- Definimi i qëllimeve strategjike dhe dinamikës kohore për zbatimin e strategjisë dhe përgatitjen e planit aksionar. Në bazë të konceptit për strategji dhe analizave dhe konkluzioneve nga aktivitetet e realizuara, ekipi i Institutit “Euro – Ballkan”, në konsultim me ekipin e Qytetit të Shkupit, i definoi qëllimet dhe aktivitetet strategjike.

DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Strategjia me një plan veprimi për zhvillim kulturor të Qytetit të Shkupit të peridhes 2012-2015 hyn në fuqi ditën e shpalljes në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit”.